



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3233/5 prot.

Datë 27.11.2025

V E N D I M
Nr.1758/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Shehu” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-65357-10-16-2025, me objekt: “Mirembajtje te rrugeve administrative (nderhyrje emergjente per pastrim bore.”, me fond limit 4,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Shehu” SHPK, me NIPT J66702707S dhe adresë: Ndertesa 1- kateshe, me zone kadastrale nr. 2592 dhe me nr. pasurie 440, ne rrugen nacionale Peshkopi, Dibër

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Bulqizë me adresë Lagja “Minatori”, Bulqizë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.10.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-65357-10-16-2025, me objekt: “Mirembajtje të rrugëve administrative (nderhyrje emergjente për pastrim bore.”, me fond limit 4,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

II.2. Në datën 27.10.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se në datën 04.11.2025, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH), si më poshtë:

1. Shehu	3,398,000	lekë	Skualifikuar
----------	-----------	------	--------------

II.4. Operatori ekonomik “Shehu” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi me arsyet se: *“Operatori ekonomik nuk ploteson kriterin 2.3.1 të Dst në lidhje me punën e ngjashme pasi Operatori ekonomik ka ngarkuar si punë të ngjashme:*

1. Mirembajtje emergjente e rruges Kthesa e Lapidarit -Rreshen 25.8 km Nr 5087/9 date 21.10.2024 .Nga vlerësimi I preventivit rezulton që kjo kontratë nuk e përmbush kriterin pasi natyra e objektit të kontratës nuk është punë e ngjashme me objektin e prokurimit .

2. Operatori ekonomik ka paraqitur faturë me situacion pjesor nr 1 me bashkinë Diber. Duke qenë se situacioni është pjesor nuk e verteton që kontrata është përmbushur me sukses .

3. Operatori ekonomik ka ngarkuar kontratën me objekt : Mirembajtje të rrugëve administrative (nderhyrje emergjente për pastrim bore) me Bashkinë Bulqizës nr 5925 date 03.12.2024 .Duke qenë se situacioni është pjesor nr 1 nuk e verteton se kontrata është përmbushur me sukses ”.

II.5.Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 05.11.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 11.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6066 dhe nr.3233/2025 prot, datë 12.11.2025 i operatorit ekonomik “Shehu” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Shehu” SHPK nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3233/1 prot., datë 13.11.2025.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën 6229 prot., datë 17.11.2025, me objekt “Dërgim vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave”, protokolluar me tonen me nr.3233/2 prot., datë 20.11.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të prokurimit Publik vendimin e

Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) nr.1, datë 17.11.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Shehu” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj duke argumentuar: [...] *Në pikën 2.3.1 të DST specifikohet që Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit. Nga verifikimi i dokumentave të operatorit ekonomik për pikën 1 të skualifikimit, tek situacioni në lidhje me objektin ”Mirembajtje emergjente e rruges Kthesa e Lapidarit -Rreshen 25.8 km” të punime emergjente që lidhet me objektin e prokurimit, totali i shërbimit të kryer është 146 520 (njëqind e dyzetë e gjashtë mijë e pesëqind e njezete), kjo e percaktuar në pikën tre të situacionit, punime emergjente, pikat e tjera të situacionit që kanë të bëjnë me punime mirëmbajtje, punime rehabilitimi etj, nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit. Si rrjedhojë vlera e punimeve emergjente nuk përmbush 20% e vlerës së kërkuar në pikën 2.3.1 të DST-së.*

Përsa i përket dy pikave të tjera për të cilat operatori është skualifikuar kontrata që është sjellur nga ana e operatorit konkretisht për objektin: "Mirëmbajtje të rrugëve administrative (ndërhyrje emergjente për pastrimin e bores bashkia Bulqizë)" si dhe situacioni dhe fatura tatimore nga Bashkia Dibër, situacion Pjesore, nuk vërtetojnë që kontrata është realizuar me sukses, si pasojë nuk përmbush kriterin 2.3.1 të DST-së.

Sa me sipër ankesës se paraqitur, komisioni i shqyrtimit të ankesave

VENDOS:

1.Mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “SHEHU” shpk, në lidhje me pretendimin e tij për skualifikim të padrejtë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Shehu” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet: *“Operatori ekonomik nuk ploteson kriterin 2.3.1 të Dst në lidhje me punën e ngjashme pasi Operatori ekonomik ka ngarkuar si punë të ngjashme:*

1. Mirembajtje emergjente e rruges Kthesa e Lapidarit -Rreshen 25.8 km Nr 5087/9 date 21.10.2024 .Nga vlerësimi I preventivit rezulton që kjo kontratë nuk e përmbush kriterin pasi natyra e objektit të kontratës nuk është punë e ngjashme me objektin e prokurimit .

2. Operatori ekonomik ka paraqitur fature me situacion pjesor nr 1 me bashkine Diber. Duke qene se situacioni eshte pjesor nuk e verteton qe kontrata eshte permbushur me sukses .

3. Operatori ekonomik ka ngarkuar kontraten me objekt : Mirembajtje te rrugeve administrative (nderhyrje emergjente per pastrim bore) me Bashkine Bulqizes nr 5925 date 03.12.2024 .Duke qene se situacioni eshte pjesor nr 1 nuk e verteton se kontrata eshte permbushur me sukses”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj marrëveshje kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.1.2.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se peratori ekonomik “Shehu” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- 1. Kontratë shërbimi nr.5087/9 prot., datë 21.10.2024 lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe operatorit ekonomik ”Shehu” SHPK me vlerë xxx lekë pa tvsh me objekt ”Mirëmbajtje emergjente e rrugës kthesa e Lapidarit – Rrëshen,
- Vërtetim nr.39488 prot., datë 15.10.2024 për realizim kontrate.
- 2. Kontratë shërbimi nr.5925 prot., datë 03.12.2024 lidhur ndërmjet Bashkisë Bulqizë dhe operatorit ekonomik "Shehu" SHPK me vlerë xxx lekë pa tvsh me objekt "Mirëmbajtje të rrugëve administrative (ndërhyrje emergjente për pastrim bore) ”.
- 3. Situacion pjesor nr.1 për kontratën me objekt “Mirembajtje rutine dhe dimërore e rrugëve në Njësitë Adiministrative në Bashkinë Dibër2024-2025”

III.1.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- *Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

III.1.4. Neni 41 “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”, në pikën 2 dhe 3, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

III.1.5. Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje 34 me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme

III.1.6. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor, në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.1, sipas të cilit: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit.* Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2 të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, e më konkretisht *Formulari i vlerësimit për realizimin e kontratës së shërbimit nr.5087/9 prot., datë 21.10.2024, lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe operatorit ekonomik "Shehu" SHPK, me objekt "Mirëmbajtje emergjente e rrugës kthesa e Lapidarit Rrëshen, 25.8 km" ku vlera e realizuar është xxx lekë me tvsh,* Komisioni vlerëson se ky dokumentacion i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues është në përputhje me kriteret e kualifikimit, pasi shërbimet e mëparshme të kryera dhe të deklaruara prej tij, për nga natyra, janë të ngjashme me shërbimet e parashikuara në procedurën objekt ankimi. Konkretisht, kontrata e shërbimit me objekt *"Mirëmbajtje emergjente e rrugës kthesa e Lapidarit – Rrëshen, 25.8 km",* përmbush kërkesën për ngjashmëri me kontratën objekt ankimi *"Mirëmbajtje të rrugëve administrative (nderhyrje emergjente për pastrim bore".* Në referim të sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ankimues "Shehu" sh.p.k. është në kushtet e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në lidhje me kërkesën për shërbime të mëparshme të ngjashme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Shehu” SHPK në procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-65357-10-16-2025, me objekt: “Mirembajtje të rrugëve administrative (nderhyrje emergjente për pastrim bore.”, me fond limit 4,166,667.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues “Shehu” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim duke e kualifikuar atë.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentur veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shehu” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

